Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit) .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Vlerësimit;
 - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 - 6. Preventivin e çmimeve
 - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
A		Projektimi				
A1.		STUDIM PROJEKTIMI SIPAS TOR				
B		Rruga e Aksesit				
B.1		PUNIME GËRMIMI PRISHJE DHE TRANSPORTI				
B.2		PUNIME B/A VEPRA ARTI, DRENAZHIME				
B.3		PUNIME NË RRUGË, SHTRESA RRUGORE				
B.4		PUNIME TE TJERA NDIHMESË PER RRUGEN				
C		Thellimi i Portit				
C.1		EKZEKUTIMI I PUNIMEVE PER THELLIMIN E PORTIT				

		SIPAS TOR				
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

TERMA REFERENCE

NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS SË AKSESIMIT DHE ANKORIMIT PËR OPERIMIN E ASETIT GJENERUES TERMİK, NË PORTIN E PESHKIMIT TRIPORT - VLORË.

Hartohen këto Terma Reference bazuar në Urdhrin e Administratorit me Nr. 3502/1 Prot., datë 19.07.2022 për ngritjen e Grupit të punës për hartimin e Termave të Referencës së realizimit të punimeve me objekt “Ndërtimi i infrastrukturës së aksesimit dhe ankorimit për operimin e asetit gjenerues termik, në portin e peshkimit Triport - Vlorë”, me qëllim thellimin e tabanit të basenit të portit të peshkimit Triport – Vlorë, nga hyrja e portit deri tek vend-ankorimi i parashikuar për mjetet lundruese të gjenerimit të energjisë si dhe rikonstrukcionin e rrugës së shërbimit sipas kërkesave të kontraktorit BOE “Excelebrate Energy” & “Renco” drejtuar DGJ me shkresë përcjellëse Nr. 3502 Prot., datë 18/07/2022.

1. Të përgjithshme.

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) është një kompani publike e licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar nga asetet gjeneruese që ka nën administrim.

Modeli aktual i Tregut të Energjisë Elektrike, i miratuar nga ERE, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 620, datë 22 Tetor 2021 për: “Miratimin e kushteve të Detyrimit të Furnizimit Publik (DFP) për të licencuarit e Sektorit Energjistik Shqiptar, gjatë periudhës së gjëndjes së jashtëzakonshme të furnizimit me energji, për të parandaluar dhe përballuar pasojat e krizës globale të energjisë” e ngarkon KESH sh.a. me detyrimin që të sigurojë të gjithë energjinë e nevojshme për të përmbushur nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU). Për përmbushjen e këtij detyrimi, KESH duhet të përdorë së pari energjinë e prodhuar nga

asetet e veta gjeneruese duke e kombinuar me marrëveshje shkëmbimi apo depozitimi, dhe në rast të mosplotësimit të kërkesës së FSHU, të blejë pjesën tjetër në tregun e parregulluar.

Përmbushja e DFP në kushtet e krizës globale energjitike të shoqëruar me ngritjen e menjëhershme të çmimeve të energjisë në tregjet rajonale si dhe varësia e prodhimit të energjisë nga kushtet hidro meteorologjike, e vendos KESH sh.a. në një trysni jo të zakonshme financiare dhe operationale. Qeveria e Shqipërisë u angazhua në mbështetje të KESH sh.a. për përmbushjen e DFP me kosto sa më të ulët, dhe për minimizimin e pasojave të çmimeve të rritura dhe të parashikueshme të energjisë në tregjet rajonale.

Nëpërmjet VKM Nr. 757, datë 21 Dhjetor 2021, për “Disa ndryshime në VKM Nr. 620, datë 22 Tetor 2021”, Qeveria e Shqipërisë autorizon KESH sh.a., që në përputhje me nevojat dhe mundësitë që do të paraqiten, t’i drejtohet tregut ndërkombëtar për të marrë përkohësisht (1-2 vjet) me qera asete gjeneruese termike shtesë, të cilat mund të instalohen dhe lidhen lehtësisht me Rrjetin e Transmetimit të Energjisë në Shqipëri.

2. Gjendja aktuale.

KESH sh.a., nëpërmjet shoqërisë TEC-Vlora sh.a., ka në administrim një impiant gjenerues termik me cikël të kombinuar prej 97 MW (TEC-in e Vlorës), i cili aktualisht nuk funksionon dhe mbahet në gjëndje konservimi. Impianti ndodhet në Pyllin e Sodës, në veri të qytetit të Vlorës, buzë detit dhe pranë portit të peshkimit të Triportit (jo më larg se 1000m).

TEC-i Vlorës lidhet me rrjetin e transmetimit të Shqipërisë nëpërmjet linjës së transmetimit të tensionit të lartë TEC Vlora – NS Babicë (220kV/50Hz) dhe ka të vendosura depozita karburanti për depozitimin e karburanteve të lëngshëm.

Për shkak të vendndodhjes dhe përparësive infrastrukturore, impianti gjenerues do të jetë i lundrueshëm dhe do të pozicionohet brenda basenit të Triport-it duke mundësuar distancën e shkurtër të lidhjes me терминаlet e linjës së transmetimit të TEC-it (lutemi ti referoheni vizatimeve bashkëlidhur). KESH sh.a. do të sigurojë të drejtat e përdorimit të basenit të Triport-it për vendosjen e impiantit.



Fig. 1. Ortofoto

3. Qëllimi, objektivat dhe detyrat kryesore të termave të referencës.

Qëllimi. Është krijimi i infrastrukturës së nevojshme për aksesim dhe operim optimal në zonën portuale detare, si dhe në atë tokësore në brendësi të territorit të Triportit Vlorë.

Termat e Referencës japin detaje konkrete mbi përmbushjen e kushteve optimale për aksesim dhe operim sipas kërkesave të kontraktorit BOE “Excelerate Energy” & “Renco”. Bazuar në kërkesat e BOE “Excelerate Energy” & “Renco”, projekt-zbatimi për realizimin e punimeve do të realizohet me qëllim thellimin e tabanit të hapsirës portuale deri në kuotën e nevojshme -4.0 m nën nivelin e detit (sipas BOE “Excelerate Energy” & “Renco”) në **Fig.4**, e cila përmbush kërkesën teknike të kontraktorit të mësipërm. Kjo e vlefshme vetëm për zonën sipas planimetrisë në **Fig.3**. Përveç thellimit të mësipërm, projekt-zbatimi duhet të hartohet edhe për realizimin e punimeve me qëllim thellimin e tabanit të hapsirës portuale në zonën përgjatë skolierës jugore të portit, deri në kuotën e nevojshme -3.0m nën nivelin e detit (sipas BOE “Excelerate Energy” & “Renco”), për krijimin e një kanali nënujor i cili vijon edhe në zonën jashtë portit me qëllim marrjen e ujit të freskët nga deti për proceset teknologjike gjatë operimit për prodhim energjie.

Për hartimin e projekt-zbatimit dhe metodologjisë së kryerjes së punimeve në territorin detar dhe tokësor të portit, duhet patur në konsideratë se gjatë zbatimit të punimeve nga ana e operatorit i cili do të kryejë punimet e zbatimit sipas këtyre termave, në terren mund të jetë prezent edhe kontraktori BOE “Excelerate Energy” & “Renco”, i cili nga ana e tij do të kryejë punime rehabilituese me qëllim krijimin e kushteve optimale për aksesimin dhe operimin e aseteve gjeneruese të energjisë.

Detyrat. Nëpërmjet hartimit të projektit dhe zbatimit të punimeve, kërkohet të sigurohet aksesueshmëri për lëvizjen dhe ankorimin e sigurtë të impianteve termike lundruese për gjenerim energjie, me specifikat e më poshtë:

Specifikimet teknike të mjeteve lundruese stacionare të ankoruara për prodhim energjie.

Një termocentral i përkohshëm, i realizuar me anë të dy mjeteve lundruese të energjisë (10x6.2MW+9x6.2MW gjeneratorë me naftë reciproke) dhe të gjitha pajisjet ndihmëse të nevojshme. Vendndodhja e Stacionit ndodhet brenda portit “Triport”, Shqipëri, përafërsisht. 4

km në veri të qytetit të Vlorës. Infrastruktura duhet të plotësoj kushtet sipas kërkesave të kontraktorit BOE “Excelerate energy” dhe “Renco” dhe referuar të dhënave në **Fig.2**.

Dimensions	
Length over all	91,44 m
Breadth moulded	24,4 m
Draught design waterline (dwl)	abt. 3 m
Height to main deck	5,5 m
Height to ridge of the roof (from deck)	14,4 m
Height to top of the stack (from deck)	36,0 m
Length of power house (steel framing)	77,4 m
Breadth of power house (steel framing)	19,0 m
Free Heights	
Store	abt. 5 m
Workshops	abt. 4 m
Offices	abt. 3,5 m
Switchgear rooms	abt. 3,5 m
Lightweight	
Complete weight of the power Commodore is about 4000 metric tonnes.	
Steel weight of the hull is about 1000 metric tonnes.	

- Rikonstrukcioni i rrugës auto që lidh vend-ankorimin e mjeteve lundruese për prodhim energjie me rrugën ekzistuese, me kushtin teknik, gjatësia rreth 200 ml dhe me gjerësi 8.0 m (sipas BOE “Excelerate Energy” & “Renco”) në **Fig.5**.

- Thellimin e tabanit të hapsirës portuale deri në kuotën e nevojshme -4.0m që përmbush kërkesat teknike të kontraktorit.

- Thellimin e tabanit të hapsirës portuale në zonën përgjatë skolierës jugore të portit deri në kuotën -3.0m , me qëllim krijimin e një kanali nënujor i cili do të përdoret nga

kontraktori për proceset e tij teknologjike gjatë operimit.

Fig. 2.




Fig.3. Planimetria e zonës që duhet thelluar e konturuar me ngjyrë të bardhë (e propozuar).




Fig. 4. Profili tërthor tip i thellimit të tabanit të basenit (e propozuar)




Fig. 5. Profili tërthor tip i rrugës auto (e propozuar)

Projekt zbatimi duhet të përmbajë:

1. Raporti mbi investigimin e gjendjes aktuale, identifikimin e problematikave, analizimin e detyrave që kërkohen për zgjidhjen e projektit.
2. Studimi gjeologjik, gjeoteknik dhe hidro-gjeologjik.
3. Rilevimi topografik dhe batimetrik i zonës përreth, profilet gjatësore dhe tërthore.
4. Evidentimin e zonave problematike duke dhënë zgjidhjet e problemeve që shfaqen.
5. Studimi dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis VNM.
6. Relacionet teknike të shoqëruara me llogaritjet përkatëse për të gjitha masat inxhinierike të parashikuara si raportet ndihmëse për topografinë, batimetrinë si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, etj.
7. Vizatimet teknike për të gjitha elementet infrastrukurore dhe thellimit të basenit që do të zbatohen me profilet tërthore dhe gjatësore sipas kushteve dhe kriterëve teknike të projektimit.
8. Specifikimet teknike ku të përcaktohen materialet e ndërtimit që do të përdoren, të dhënat e vetive fiziko-mekanike të tyre, etj.
9. Tabela e sasive metrike (volumet e punimeve) të ndara sipas profileve tërthore të dhëna në vizatimet përkatëse.
10. Preventivin e punimeve sipas normave të projektimit dhe standarteve në fuqi (sipas manualeve të ndërtimit të aprovuara me Vendimin Nr. 629, datë 15.7.2015 dhe Aktin Normativ Nr. 10, datë 18.5.2022). Preventivi të ndahen për çdo nën objekt më vehte dhe për të gjithë projektin në tërësi. Për zërat e punimeve që nuk janë të përfshira në manualin teknike të çmimeve në fuqi, konsulenti duhet t'i shoqërojë me analizë çmimi të detajuar sipas ligjit në fuqi.
11. Plani i Organizimit të punimeve që do të kryhen, i ndarë për çdo nën objekt më vehte duke marrë në konsideratë se paralelisht për realizimin e këtyre punimeve, në terren mund të jetë prezent edhe kontraktori BOE “Excelerate Energy” & “Renco”, i cili nga ana e tij do të kryejë punime rehabilituese me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për aksesim dhe operim të aseteve gjeneruese. (Kontraktorët duhet të dakortësohen për rradhën dhe procedurën e punimeve, me qëllim koordinimin e punëve pa penguar njeri-tjetrin).
12. Grafiku i punimeve për çdo nën objekt dhe radha e fillimit të punimeve për secilin prej tyre, duke përcaktuar numrin dhe llojin e makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve. (Duke marrë në konsideratë pikën 11).
13. Metodologjia e zbatimit të punimeve duke marrë në konsideratë se paralelisht me operatorin që do të kryejë këto punime në terren, mund të jetë prezent edhe kontraktori BOE “Excelerate Energy” & “Renco”, i cili nga ana e tij do të kryejë punime rehabilituese me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për aksesim dhe operim të aseteve gjeneruese.

Projekti i zbatimit sipas këtyre Termave të Referencës do të aprovohet nga Komisioni Teknik i DSD/KESH sh.a, si dhe do t'i nënshtrohet Oponencës Teknike nëse është e nevojshme, referuar termave ligjore.

Referuar specifikimeve teknike të rrugës dhe raportit teknik të thellimit të zonës portuale, të investiguar nga nevojat që ka kontraktori BOE “Excelerate Energy” & “Renco”, referojmë si orientim që volumet e punimeve të cilat do të realizohen parashikojmë të jenë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i punës	Njësia
A	Punime për thellimin e portit	
1.	Gërmim në prezencë të ujit dhe zhvendosje e materialit të ngurtë (deri në kuotën -4.0 m, ku përfshihen punimet për thellimin e basenit dhe -3.0 m e kanalit të marrjes së ujit)	m ³
B	Punime për rikonstrukcionin e rrugës lidhëse nga vend-ankorimi i parashikuar i mjeteve lundruese deri në rrugën kryesore.	
1.	Mbushje me çakëll e gurë gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri (t=45cm)	m ³
2.	Shtresë zhavorri t=30cm, me cilindrim	m ²
3.	Shtresë stabilizant t=15cm	m ²
4.	Shtresë binderi me granil gurë kave, 8cm, me makineri	m ²
5.	Shtresë asfaltbetoni me granil gurë kave, 5cm, me makineri	m ²
6.	Ndërtim kanali/kunetë në dy anët e rrugës me beton, për drenazhimin e ujrave sipërfaqësore	m ³
7.	Të parashikohen punimet për infrastrukturën (si: elektrike, telefonia, interneti, interseptimi i kanalizimit të ujrave të zeza nëse ka si dhe ujësjellësit, etj.)	ls

4. Standartet Teknike që do të përdoren për hartimin e projektit.

Projekti do të hartohet në përputhje me normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi, të sigurojë respektimin e standardeve teknike si dhe kushteve teknike KTP dhe KTZ. Në mënyrë të veçantë, duhet të respektojë, kërkesat e Ligjit Nr. 9130, datë 08.09.2003, “Për Autoritetin Portual”, si dhe të Ligjit Nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”. Standartet teknike duhet te zbatohen duke ju referuar termave te referencës te hartuara në këtë material. Për projektimin e rrugës Konsulenti të referohet VKM 628, date 15.07.2015 "Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve", Ligji Nr. 8378, datë 22.7.1998 (I ndryshuar) Kodi rrugor, VKM 153, date 07.04.2000 “ Rregullore e Zbatimit te Kodit Rrugor” si dhe çdo akt ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse në fuqi. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të besueshmërisë dhe realizueshmërisë me

praktikën shqiptare dhe kufizimet për financimin e veprës. Detajet teknike duhet të jepen nga Projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

5. Afatet dhe raportet që do të dorëzohen.

Afati i realizimit të projekt-zbatimit parashikohet të përfundojë brenda 15 ditë pune nga data e lidhjes së kontratës. Projekti i zbatimit do të kalojë vetëm në një fazë të vetme, ku do të kryhet investigimi në terren dhe hartimi i projekt zbatimit sipas tabelës së mëposhtme:

Nr .	Përshkrimi i aktivitetit	Produkti përfundimtar	Afati i dorëzimit
1	Hartimi i Projekt - Zbatimit	Projekt – Zbatimi (4 kopje të printuara + 4 kopje elektronike (CD))	Jo më shumë se 10 ditë pune
2	Zbatimi i punimeve	Sipas kontratës	Jo më shumë se 90 ditë pune
3	Garancia e defekteve	Garancia e defekteve	Jo më pak se 24 muaj

***Shënim.** Periudha për afatet e shqyrtimit dhe aprovimit të projekt-zbatimit nga KESH sh.a. dhe Oponenca Teknike nuk përlllogaritet në afatin e zbatimit të kontratës.*

Kontraktori (Konsulenti) duhet të përcaktojë me detaje sipas fazave të parashikuara afatet kohore të realizimit të punimeve. Afatet e dhëna në tabelën më sipër janë vetëm orientuese. Afatet do të jenë në funksion i metodologjisë së ndërtimit dhe organizimit të brendshëm të kontraktorit. Në çdo rast afatet e dhëna nga Konsulenti duhet të jenë të arsyetuara të shoqëruara me shpjegimet e përdorimit, ciklit të punës së makinerive dhe fuqisë punëtore.

6. Të dhëna dhe mbështetja që do të ofrohen nga KESH sh.a.

Me qëllim realizimin e shërbimit sipas termave të referencës, hartuesi i projekt-zbatimit, nëse e ka të nevojshme mund të sigurojë informacionet e nevojshme në bashkëpunim me institucionet lokale dhe qendrore në vend. KESH do të vërë në dispozicion të gjithë informacionin që disponon (studime, materiale, vizatime) të gjeneruara nga kontraktori “Renco” & “Exelerate” në mënyrë që projektet të bashkërendohen. Stafi i KESH do të sqarojë çdo paqartësi për termat e referencës.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

-  Afati i përgatitjes së projektit 10(dhjetë) ditë pune
-  Afati i zbatimit të punimeve 90 (nëntëdhjetë) ditë pune

Shënim: Ky afat zbatimi është vetëm për kontraktorin dhe nuk ndikon në afatet të cilat janë të nevojshme për Autoritetin Kontraktor.

Grafiku i zbatimit për ofertim.

Nr	Përshkrimi i afatit	Njësia	Afati Max	Afati i Propozuar
1.	AFATI PER STUDIM PROJEKTIM	Ditë pune	10	
2.	EKZEKUTIMI I TË GJITHA PUNIMEVE	Ditë pune	90	
3.	GARANCIA E OBJEKTIT	Muaj	24	

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas shtojcës 8

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përse i përket aftësisë teknike e profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe

Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P - 1/A Punime gërmimi në tokë.
- N.P - 4/A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pistaAeroportuale
- N.P - 5/A Punime nentokesore Ura e Vepra Arti
- N.P - 8/E Ndërtime Detare dhe punime thellimi uji
- N.P - 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 6/A Sinjalistike rrugore jo ndriçuese
- N.S - 18/A Punime topogjeodezike
- NS - 20/A Shpime Gjeologo - Inxhinierike, puse e shpime për ujë

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesin licencë të vlefshme për projektimi ose të kontraktojë me një shoqëri projektuese të licencuar sipas rregullores së miratuar në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”, Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- 6.a Projektim rruge lokale , rruge urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore
- 7.a Ura dhe vepra arti të vogla deri në 10m.
- 8.a Rilevime inxhinierike
- 9.d Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët
- 9.e Studime e projekte hidrogjeologjike
- 11.a Projektim sinjalistike jondriçuese në rrugë lokale , rrugë urbane dytësore , rrugë interurbane dytësore , sheshe e parkime
- 12.a Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
- 12.e Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 100 (njëqind) punonjës për periudhën (Maj 2022- Korrik 2022):

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Maj 2022- Korrik 2022).

2.3.5 Operatorët ekonomik duhet të ketë të punësuar personelin kryesor si Drejtues teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2022- Korrik 2022), stafi inxhinierik si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1(një) Inxhinier Ndërtimi, me experience pune minimale 15vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, me experience pune minimale 10 vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Gjeodet, me experience pune minimale 15vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Gjeolog, me experience pune minimale 15 vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Hidroteknik me experience pune minimale 15 vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Mjedisi me experience pune minimale 10 vjet

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë,
- CV,
- Librezë e pune

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2022- Korrik 2022), stafin mbështetës si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1 (një) inxhinier ndërtimi
- ✚ minimalisht 2 (nje) inxhinier hidroteknik,
- ✚ minimalisht 1 (nje) Ekspert mjedisi te pajisur me Çertifikate “Për Vlersimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”,
- ✚ minimalisht 1(një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë,
- ✚ minimalisht 1 (një) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier",
- ✚ minimalisht 1 (një) mjek të përgjithshëm të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë / certifikatë

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 5(pesë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi drejtimi

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001: 2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";
- c) ISO 45001: 2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" .

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me :

- Licensë Kodi III.2.A (1+2) “Ndikimi në mjedis, Auditim Mjedisor” .
- Licensë Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte e dherave”

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Licensat e kërkuara më sipër.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 3.5 -5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me vinxh me kapacitet mbajtës 5-10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës jo më pak se 20 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera

Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë Thithese	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozita uji 5000 litra	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Rula vibrues	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibratore betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor ajri	1 copë	Pronësi ose me qera
Motosaldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Kulle ndricimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Betoni	1 copë	Pronësi / qera/ Furnizim
Zyre Kantieri	1 copë	Pronësi ose me qera
Drage - Ponton gjërmimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Maune vetshkarkuese në port (Split Barge)	1 copë	Pronësi ose me qera

“Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njëzia vendore dhe fotot përkatëse;

- Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
 - c) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

-Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se disponon mjet Maune vetshkarkuese në porte (Split Barge) e rregjistruar në regjistrin Detar Shqiptar. Për të cilën duhet të paraqesë Certifikatë të vlefshme regjistrimi në regjistrin Detar Shqiptar dhe foto. Në rast se mjeti është marë me qera duhet të paraqesë edhe kontratën e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit te kontratës objekt i këtij prokurimi

- Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se disponon mjet Platformë për realizimin e gërmimit në det (Ponton gërmimi) , për të cilin duhet të paraqesë specifikimet teknike dhe fotot përkatëse. Në rast se mjeti është marë me qera duhet të paraqesë edhe kontratën e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit te kontratës objekt i këtij prokurimi

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Shtojca 8.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

<p>data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
